



Kanton Zürich  
Bildungsdirektion

# Një përkujdesje e mirë para fillimit të shkollës, do të thotë një përgatitje e mirë për shkollën

Fletënjoftim për prindërit

Albanisch  
Shqip

## **Të dashur prindër**

Ju dëshironi që fëmija Juaj të zhvillohet shëndoshë dhe të ketë sukses në jetë. Për suksesin e mëvonshëm shkollor, janë pikërisht vitet e para të jetës vendimtare. Përveç dashurisë dhe ndjenjës së sigurisë, fëmijës Tuaj i nevojitet që në kohët e hershme kontakti me fëmijët e tjerë, një mjedis stimulues dhe mundësia për të mësuar gjermanisht. Grupet e lojërave, çerdhet për fëmijë dhe familjet për përkujdesje ditore, i ofrojnë fëmijës Tuaj të gjitha këto gjëra dhe ju lejojnë Ju, që të shkoni të punoni, pa pasur merak për fëmijën Tuaj.

### **Çfarë janë grupet e lojërave (Spielgruppen) dhe çfarë ofrojnë ato?**

Në grupet e lojërave marrin pjesë 8 deri në 10 fëmijë nga 3 vjeç deri në moshën e kopshtit për fëmijë. Grupet e lojërave organizohen disa herë në javë, zgjasin 2 deri 3 orë dhe udhëhiqen profesionalisht. Kostot duhet ti marrin prindërit vetë përsipër.

### **Çfarë janë çerdhet për fëmijë (Kinderkrippen) dhe çfarë ofrojnë ato?**

Në çerdhet për fëmijë, fëmijët nga 2 muajsh deri në moshën për kopsht, përkujdesen nga personat e specializuar pedagogjikë. Fëmijët frekuentojnë çerdhen gjysëm dite, 5 herë në javë dhe janë përafërsisht me 10 fëmijë të tjerë në një grup. Në qoftë se Ju punoni, fëmija Juaj është në duar të sigurta dhe i përkrahur në zhvillimin e tij. Shumë komuna i marrin përsipër një pjesë të kostove.

### **Çfarë janë familjet për përkujdesje ditore (Tagesfamilie) dhe çfarë ofrojnë ato?**

Në një familje për përkujdesje ditore, fëmija Juaj është i përkujdesur si në shtëpi dhe ai shpesh ka edhe fëmijë të tjerë të familjes për të luajtur. Ju dhe familja për përkujdesje ditore bini dakort mbi orët e përkujdesjes për fëmijën Tuaj sipas nevojave tuaja. Në të shumtën e rasteve kujdestarja ditore nuk ka formim pedagogjik, por ajo mbikqyret nga institucionet përkatëse. Disa komuna marrin pjesë në kostot.

Në linkun [www.lotse.zh.ch](http://www.lotse.zh.ch) Ju do të gjeni informacione të tjera dhe njoftime mbi atë, se si mund të gjehet një vend i lirë. Familjet për përkujdesje ditore i gjeni në linkun [www.vzt.ch/mitglieder](http://www.vzt.ch/mitglieder).